

QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE NDAJ PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË
VEÇANTA NË KLASAT E RREGULLTA NË CIKLIN E ULËT MËSIMOR NË KOMUNËN
E ULQINIT

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

ANESA CUCA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

PRISHTINË

Korrik, 2023

Kandidatja: Anesa Cuca

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Dashmir Bërxulli

Qëllimi kryesor i studimit është të eksplorojë dhe përshkruaj qëndrimet e mësimitdhënësve të ciklit të ulët fillor ndaj përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta në Komunën e Ulqinit. Për të plotësuar qëllimin e studimit janë marrë parasysh edhe perspektiva dhe përceptimet e prindërve të fëmijeve me nevoja të veçanta ndaj përfshirjes së fëmijeve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta. Ky studim është paraqitur si nevojë e të paturit një pasqyrë më të qartë të funksionimit të edukimit inkluziv në Komunën e Ulqinit, duke pasur në konsideratë që deri më sot në Komunën e Ulqinit nuk ekzistojnë të dhëna shkencore që tregojnë për qëndrimet e mësimitdhënësve dhe prindërve ndaj përfshirjes së fëmijeve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

Ky punim është ndarë në disa kapituj:

Kapitulli i parë: Hyrja

Në pjesë hyrëse është diskutuar mbi evaluimin e edukimit inkluziv në aspektin global, duke vazhduar me zhvillimin e edukimit inkluziv në shkollat fillore në Mal të Zi, përparësitë dhe vështirësitë eventuale. Në pjesë qendrore të kapitullit të parë është diskutuar në veçanti për funksionimin e sistemit arsimor në kuader të edukimit inkluziv në Mal të Zi, aspekteve ligjore dhe strategjive arsimore të fushëveprimit inkluziv në klasa të rregullta. Një diskutim është kushtuar mungesës së statistikave reale për sa i përket numrit të fëmijeve me nevoja të veçanta në Komunën e Ulqinit dhe mungesës së hulumtimeve të kësaj fushe. Si pjesë e këtij kapitulli, është paraqitur edhe perspektiva teorike që ka përkrahur qëllimin e studimit në fjalë.

Hipotezat e ngritura të studimit janë 4:

H1: Mësimitdhënësit kanë qëndrime pozitive ndaj përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

H2: Mësimdhënësit që kanë qenë më shumë të përfshirë në ndjekjen e trajnimeve kanë qëndrime më pozitive ndaj gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

H3: Mësimdhënësit me nivel më të lartë të edukimit kanë qëndrime pozitive ndaj gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

H4: Mësimdhënësit me përvojë më të shkurtër në arsim kanë qëndrime pozitive ndaj gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

Kapitulli II: Shqyrtim i literaturës

Në kapitullin e dytë, bëhet paraqitja e të gjeturave nga literatura, duke u dhënë kështu përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura me qëllim zbërthimin e qëllimit të përgjithshëm të studimit. Shqyrtimi i literaturës është ndarë sipas këndvështrimit të mësimdhënësve ndaj përfishrjes së fëmijeve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta, si dhe perspektives së prindërve ndaj përfishrjes së fëmijeve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta. Po ashtu, janë detajuar faktorët individual që mund të ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve ndaj përfshirjes së fëmijeve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.

Kapitulli III: Metodologjia

Në pjesën e metodologjisë, është përshkruar dizajni i studimit, është shpjeguar mënyra e mostrimit, metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit, instrumentet matëse, procedurat e hulumtimit dhe çështjet etike, si dhe analizat statistikore të përformuara. Në këtë studim pjesë e mostrës ishin 44 mësimdhënës shqipfolës të ciklit të ulët fillor të angazhuar në katër shkolla fillore në Komunën e Ulqinit. Gjithashtu pjesëmarrës në këtë studim kanë qenë dhe 5 prindër apo pesë nëna të fëmijeve me nevoja të veçanta të cilët janë ftuar të jenë pjesë e fokus grupit. Procedura për mostrim ishte me kampionim të qëllimshëm, me metodë të kombinuar dhe me dizajn deskriptiv, korrelacional dhe regresional.

Kapitulli IV: Rezultate - kuantitative dhe kualitative

Te pjesa e rezultateve, fillimisht përshkruhen rezultatet kuantitative dhe pastaj ata kualitative. Rezultatet kuantitative tregojnë se përgatitja profesionale ka ndërlidhje të fortë pozitive me përvojën në arsim, gjithashtu të gjeturat tregojnë se ka ndërlidhje të fortë pozitive në mes të përgatitjes profesionale dhe trajnimeve, si dhe përvojës në arsim dhe trajnimeve. Ndërlidhje e moderuar pozitive është gjetur në mes të qëndrimeve pozitive dhe përgatitjes profesionale, qëndrimeve pozitive dhe përvojës në arsim si dhe qëndrimeve pozitive dhe trajnimeve. Nga

rezultatet e e analizës së regresionit mund të themi se përgatitja profesionale ka ndikim signifikant pozitiv në qëndrimet pozitive të mësimeve. Në anën tjetër, variabla për ndjekjen e trajnimeve nuk ka rezultuar në ndikim signifikant pozitiv në qëndrimet e mësimeve. Në mënyrë të ngjashme, as përvoja në arsim nuk ka treguar të ketë një ndikim signifikant pozitiv në qëndrimet pozitive të mësuesve. Derisa nga rezultatet kualitative janë identifikuar 3 tema të cilat reflektojnë perspektivat e prindërve në lidhje me praktikën e arsimit gjithëpërfshirës. Temat të cilat janë identifikuar janë: “Shkolla - ambient gjithëpërfshirës”, “Trajnimet dhe përvoja në arsim - faktor pozitiv për gjithëpërfshirje” dhe “Bashkëpunimi efektiv prind - asistent – mësime”.

Kapitujt e fundit: Diskutim, Kufizime, Konkludime, Rekomandime, Referenca dhe Shtojcë

Në kapitujt e fundit të këtij studimi janë diskutuar rezultatet nga studimi, limitet e këtij studimi dhe konkludimet. Nga interpretimi i rezultateve dy nga hipotezat e ngritura në studim janë vërtetuar plotësisht derisa dy të tjerat nuk janë mbështetur plotësisht. Poashtu, në kapitullin në vazhdim janë dhënë disa rekomandime dhe implikime eventuale me qëllim të promovimit të qëndrimeve pozitive dhe pranues të mësimeve me qëllim të ruajtjes së një kulture të drejtave të barabarta për të gjithë nxënësit.